



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:059719  
Datë: 12.03.2024  
Numri i dokumentit: 05440529

Pml.nr.108/2024

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Valdete Daka, kryetare, Agim Maliqi dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarës M. M., për shkak të veprës penale vjedhja e rëndë nga neni 315 par.2 nënpar.2.1 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarës, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.2023:059719 të datës 27.06.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i përgjithshëm PA1.nr.1036/2023 të datës 26.10.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më 7 mars 2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarës M. M. e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm P.nr.2023:059719 të datës 27.06.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm PA1.nr.1036/2023 të datës 26.10.2023.

**A r s y e t i m**

## **Vendimi i Gjykatës Themelore**

Gjykata Themelore në Gjakovë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin P.nr.2023:059719 e datës 27.06.2023, të dënuarën M. M. e ka shpallur fajtores për shkak të veprës penale dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej ... vite në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim nga data 06.03.2023 deri më datë 27.06.2023. E dënuara është obliguar në pagesën e shumës prej ... €, në emër të paushallit gjyqësor dhe shumën prej ... € në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit, kurse e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

## **Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës**

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.1036/2023 të datës 26.10.2023, ka aprovuar si të bazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarës përkitazi me vendimin për dënim në atë mënyrë që për veprën penale të shpallur fajtores ei ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej ... muaj në të cilin dënim i është llogaritur koha e kaluar në paraburgim nga data 06.03.2023 deri me datë 27.06.2023. Pjesët e tjera të aktgjykimit kanë mbetur të pandryshuara.

## **Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë**

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarës M. U., avokati Besnik Haxhijanuzi nga Gjakova, pa përcaktuar bazën ligjore, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë dhe aktgjykimet e kundërshtuara të ndryshohen dhe të dënuarës të i shqiptohet një dënim më i butë.

## **Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit**

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.62/2024 e datës 16.02.2024 ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

## **Pretendimet e paraqitura në kërkesë**

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit thekson se aktgjykimet e kundërshtuara nuk kanë gjetur rrethana rënduese e njëkohësisht megjithëse ka pasur mjaft rrethana lehtësuese, por të njëjtat nuk janë vlerësuar me rastin e përcaktimit për llojin dhe lartësinë e dënimit.

Në vijim të kërkesës janë potencuar rrethanat lehtësuese, se e dënuara është nënë e një fëmije të moshës shtatë vjeçare, se është mbajtëse e vetme e familjes së saj, se është e gjendjes së varfër ekonomike dhe të ardhurat i siguron përmes punës së saj të kohëpaskohshme. Gjithashtu theksohen se e dënuara ka shprehur pendim dhe sjellje korrekte gjatë gjykimit dhe është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin, andaj të gjitha këto rrethana prezentë do të duhej që të ndikonin në shqiptimin e dënimit më të butë.

### **Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës**

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPPK) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësit të të dënuarës janë të pabazuara, ngase aktgjykimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa, nuk përmbajnë shkelje për të cilat pretendohet.

Duke shqyrtuar pretendimet konkrete të paraqitura në kërkesën e mbrojtësit të të dënuarit Gjykata Supreme e Kosovës vëren faktin se nga përmbajtja e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, del se kontestohet vendimi për dënimin për të cilën bazë kërkesa nuk mund të ushtrohet. Megjithatë, bazuar në dispozitën e nenit 385 par.5 të KPP-së kur është fjala për vendimin për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, vendimi për dënim nuk mund të kundërshtohet, kurse shkelja e ligjit penal vlerësohet në rastet kur në marrjen e vendimit për dënim gjykata i ka tejkalluar kompetencat ligjore. Pra, nuk është në kompetencë të Gjykatës Supreme të Kosovës shqyrtimi i lartësisë së dënimit të shqiptuar, por e rëndësishme është se me rastin e shqiptimit të dënimit nuk janë tejkalluar kompetencat ligjore dhe arsyet e dhëna për vendimin për dënim, nuk janë të përfshira në shkelje procedurale. Nga përmbajtja e aktgjykimit të kundërshtuar me kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë del se në mënyrë të plotë dhe gjithëpërfshirëse janë potencuar të gjitha rrethanat relevante përkitazi me llojin dhe lartësinë e dënimit të shqiptuar, për më tepër, në dënimin e shqiptuar janë vlerësuar edhe rrethanat që potencohen në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë

e që këto rrethana kanë pasur ndikim që gjykata e shkallës së parë ka aplikuar institutin e zbutjes së dënimit dhe i cili dënim është zbutur edhe nga ana e gjykatës së shkallës së dytë e që bazuar në këto rrethana të dënuarës i është shqiptuar dënim nën minimumin e përcaktuar ligjor.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË**

Pml.nr.108/2027, më 7 mars 2024

B.profesional,  
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,  
Valdete Daka